

L I G J
Nr.8100, datë 28.3.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 “PËR TARIFAT
DOGANORE” (I NDRYSHUAR ME DISA LIGJE TË TJERA)**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore” (i ndryshuar me disa ligje të tjera), shtohen nenet si vijon:

Neni 20/1

Për qëllime zbatimi të dispozitave të këtij ligji:

a) me shprehjen “përjashtim nga taksat doganore të importit” kuptohet çlirimi i mallrave për përdorim të brendshëm pa paguar taksat doganore të importit, pavarësisht nga pozicioni tarifor normal, me kusht që ato të importohen në rrethana të caktuara dhe për qëllime të caktuara;

b) me shprehjen “çlirim për përdorim të brendshëm” kuptohet procedura doganore, sipas së cilës mallrat e importuara edhe mund të mbeten përfundimisht në territorin doganor shqiptar, procedurë që parashikon pagimin e taksave dhe detyrimeve të tjera doganore dhe plotësimin e të gjitha formaliteteve doganore;

c) me shprehjen “mallra shqiptare” kuptohen:

(i) mallrat tërësisht të prodhuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

(ii) mallrat e ardhura nga territore që nuk janë pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që janë me qarkullim të lirë në territorin doganor shqiptar; dhe

(iii) mallra të përfituara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë prej mallrave të pikës (ii), ose prej mallrave të pikës (i) dhe (ii) më sipër.

d) me shprehjen “mallra me qarkullim të lirë” kuptohen mallrat që janë çliruar për përdorim të brendshëm pa kushte e që kanë të bëjnë me disponimin ose përdorimin e tyre;

e) me shprehjen “taksa doganore të importit” kuptohen taksat që caktohen në tarifën doganore, pagimi i të cilave është i detyrueshëm, kur mallrat hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

f) me shprehjen “garanci” kuptohen masat që ofrohen nga personat që deklarojnë mallra për të siguruar organet doganore se çdo detyrim ndaj doganës do të plotësohet.

Neni 20/2

Përjashtimet nga taksat doganore të importit mund të jepen për mallrat që çlirohen për përdorim të brendshëm, për mallrat që vendosen në regjime të ndërmjetme doganore, si dhe në raste të veçanta.

Neni 20/3

Përjashtimi nga taksat doganore të importit për mallrat që çlirohen për përdorim të brendshëm, jepet në këto raste:

- a) Për të gjitha mallrat e importuara në bazë të marrëveshjeve shumëpalëshe dhe dypalëshe të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe të ratifikuara nga Kuvendi Popullor, për aq sa këto marrëveshje e kërkojnë shprehimisht përjashtimin nga taksat doganore të importit. Bëjnë përjashtim nga rregulli i ratifikimit të gjitha marrëveshjet që janë nënshkruar para datës 1 korrik 1995;
- b) për prodhimin e gjuetisë së peshkut dhe prodhimet e tjera të marra në ujëra që nuk i takojnë territorit doganor shqiptar, si dhe për të gjitha prodhimet e marra nga përpunimi i prodhimeve të mësipërme në fabrikat e vendosura në bordin e anijeve që lundrojnë me flamur shqiptar;
- c) për monedhat, kartëmonedhat dhe letrat me vlerë;
- ç) për mallrat shqiptare, të cilat, duke qenë të eksportuara nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, kthehen në të njëjtën gjendje për t'u çliruar për përdorim të brendshëm, brenda tre vjetëve nga data e eksportimit;
- d) për mallrat që me udhëzim të ministrit të Financave do të përcaktohen si sende personale;
- dh) për mostrat dhe materialet e reklamës me vlerë tregtare të neglizhueshme;
- e) për substancat terapeutike me origjinë njerëzore, si gjaku njerëzor, derivate të tij dhe organe njerëzore;
- ë) për mallrat që dërgohen si ndihma a dhurata në adresë të organizatave bamirëse humanitare dhe të institucioneve shtetërore buxhetore;
- f) për materialet që shërbejnë për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe zbulimin e varrezave ushtarake, arkivolet apo urnat e personave të vdekur jashtë, si dhe lulet dhe kurorat që i shoqërojnë ata;
- g) për dokumentet dhe artikujt e ndryshëm pa vlerë tregtare;
- gj) për objektet fetare që importohen nga institucionet fetare, të cilat veprojnë në Shqipëri;
- h) për produktet që importohen për t'u nënshtruar provave.

Neni 20/4

1. Përjashtimi nga taksat doganore të importit jepet edhe për të gjitha mallrat që vendosen në regjime të ndërmjetme doganore, sipas rregullave të përcaktuara për funksionimin e këtyre regjimeve me dispozita të kodit doganor dhe udhëzimeve të ministrit të Financave.

2. Përjashtohen nga taksat doganore të importit edhe mjetet që kryejnë transportin ndërkombëtar të mallrave, personave e bagazheve të tyre, si dhe për karburantet, furnizimet e bordit dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin normal të këtyre mjeteve.

3. Me përfundimin e afateve të qëndrimit në regjimin doganor të ndërmjetëm, në qoftë se mallrat deklarohen se do të çlirohen për përdorim të brendshëm, mund të përfitojnë përjashtim nga taksat në bazë të dispozitave të parashikuara në nenin 20/3 të këtij ligji nëse plotësojnë kushtet e kërkuara në atë nen dhe në udhëzimet e ministrit të Financave, që duhen të dalin në përputhje me nenin 20/8.

Neni 20/5

Përjashtimi nga taksat doganore jepet edhe në këto raste:

- a) për barnat dhe materialet që përdoren për prodhimin e ambalazhimit të tyre nga

persona të autorizuar, sipas rregullave të caktuara në ligjin për barnat dhe në dispozita të veçanta për këtë problem;

- b) për mallrat që importohen në bazë të kredive me kushte lehtësuese të akorduara nga organizma financiarë zhvillimi;

- c) për mallrat që do të importohen për rikonstrukcionin e aeroportit të Rinasit, përjashtimi i të cilave është parashikuar në përputhje me ligjin nr.8023, datë 2.11.1995;

- ç) për mallrat që importohen nga kontraktuesit dhe nënkontraktuesit në përputhje me ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet";

- d) për mallrat që importohen nga personat, të cilët kanë fituar titullin "Person i stimuluar" në bazë të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave me përparësi turizmin";

- dh) për mjetet lëvizëse të invalidëve që administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në bazë të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit";

e) për armatimet, municionet, pjesët dhe plotësuesit e tyre, për instrumentet, aparatet dhe pjesët e tyre dhe për veshmbathjet që importohen për nevojat e Forcave të Armatosura;

ë) për mallrat e importuara nga Banka e Shqipërisë për qëllime të kryerjes së veprimtarisë së saj në bazë të ligjit nr.8076, datë 22.2.1996 “Për Bankën e Shqipërisë”.

Neni 20/6

Në të gjitha rastet kur përjashtimi nga taksat doganore bëhet me kusht, organet doganore mund të kërkojnë garanci sipas rregullave të caktuara me akte të veçanta.

Neni 20/7

Çdo dispozitë tjetër, e nxjerrë me ligje të veçanta, që ka për objekt përjashtimin nga taksat doganore të importit, duhet t’i referohet zgjerimit të listës së dhënë në nenin 20/5.

Neni 20/8

Rregullat më të hollësishme për kushtet që duhet të plotësohen dhe procedurat që duhet të ndiqen për të përfituar përjashtimin nga taksat doganore të importit, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

Neni 2

Neni 20 i ligjit nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore” (i ndryshuar me disa ligje të tjera) si dhe neni 3 i ligjit nr.7675, datë 2.3.1993; ligji nr.7733, datë 20.7.1993; ligji nr.7790, datë 9.2.1994; neni 1 i ligjit nr.7936, datë 18.5.1995; ligji nr.8018, datë 26.10.1995; ligji nr.8019, datë 26.10.1995; ligji nr.8021, datë 1.11.1995 dhe ligji nr.8041, datë 30.11.1995, shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1460, datë 9.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha